



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE E MONITORIMIT TË PROCEDURAVE

Nr. 629/4 Prot.

Tiranë, më 28.03.2024

Të dhëna mbi Vendimin

Nr. 24, datë 28.03 2024

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje të nenit 78/1/b të Ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik" (në vijim "LPP"), i ndryshuar (në fuqi në kohën e nisjes së procedimit administrativ), në ushtrim të kompetencave të saj ka nisur procedimin administrativ për përjashtimin e operatorit ekonomik "Nika" Shpk, me NIPT J76705047U, nga e drejta për të fituar kontrata publike, për mospërbushje të detyrimeve kontraktuale në realizimin e plotë të kontratës Nr. 80/11 Prot., datë 21.08.2023, me objekt: "*Hidroizolim i tarracës dhe përmirësimi i rrjetit higjieno sanitar Godina nr. 2, AQ*", të lidhur me Shërbimin Informativ Shtetëror.

APP i ushtron detyrat dhe kompetencat e saj në bazë dhe për zbatim të nenit 23 të LPP.

Operatori ekonomik ndaj të cilit ka nisur procedimi administrativ (Emri i subjektit NIPT, adresa): "Nika" Shpk, me NIPT J76705047U, me adresë: "Lagja "Vasil Shanto", Bulevardi "Skënderbeu", godinë 8 – katëshe, kati 1, Zona kadastrale 8593, nr. Pasurie 5/587" 4001, Shkodër.

I. Arsytet e fillimit të procedimit administrativ:

Procedimi administrativ ndaj operatorit ekonomik "Nika" Shpk, ka nisur për mospërbushje të detyrimeve kontraktuale në kontratat publike.

II. Gjetjet:

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur, u arrit në konkluzionin se ndodheshim në kushtet e mospërbushjes së detyrimeve kontraktuale në kontratat publike, sipas parashikimeve të nenit 78/1/b të LPP (në fuqi në kohën e nisjes së procedimit administrativ), në të cilin përcaktohet se: "*1. Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga e drejta për të fituar kontrata publike, për një periudhë nga 3 muaj deri në 3 vjet për: b) mospërbushje të detyrimeve kontraktuale në kontratat publike, që kanë ndodhur për faj të operatorit ekonomik*".

III. Masat:

Me Vendimin Nr. 24, datë 28.03.2024, APP ka vendosur të përjashtojë operatorin ekonomik "Nika" Shpk, me NIPT J76705047U, nga e drejta për të fituar kontrata publike, për 8 (tetë) muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.